



---

# IMPAKTI I COVID-19 NË SEKTORIN E TURIZMIT

---

## COVID-19 dhe SEKTORI I TURIZMIT

Turizmi bën pjesë te sektorët më të prekur nga “realiteti i ri” që ka imponuar pandemia COVID-19 në Shqipëri dhe në mbarë globin.

Pas publikimit të **Aktit Normativ Nr. 26 datë 10.06.2020, “Për marrjen e masave të përkohshme për mbështetjen e sektorit të turizmit”**, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ndërmorri një fushatë të dedikuar “aftercare” me operatorët më të rëndësishëm në sektorin e turizmit, për t’u njohur më shumë me problematikat që po has ky sektor në Shqipëri gjatë pandemisë COVID-19. Akti i plotë normativ gjendet në Aneks 1.

**Kjo fushatë aftercare ka qenë e fokusuar vetëm në një segment të caktuar të industrisë së turizmit: agjencitë turistike dhe operatorët turistikë. Logjika e kësaj fushate të dedikuar u orientua nga arsyetimi se ky segment, për vetë modelin se si e ka të ngritur aktivitetin tregtar, është një segment shumë i prekur nga pandemia (dhe pak i lakuar) pasi në këtë lloj biznesi oferta parablhet. Agjencitë e turizmit dhe operatorët turistikë i kanë parablerë ofertat për vitin 2020 që në vitin 2019, pra është një kosto e parapaguar, e ndërkohë oferta rastësore është ulur ndjeshëm.**

Për të mësuar më shumë mbi impaktin që ka patur mbyllja e kufijve gjatë periudhës së pandemisë dhe anulimi i çdo prenotimi, përveç bizneseve të cilat operojnë aktualisht në Shqipëri si agjenci dhe operatorë turistikë, është kontaktuar Shoqata e Turoperatorëve dhe Agjencie Turisitike (ATOA), e cila ka arritur të akumulojë problematikat e raportuara, duke ofruar dhe sugjerime konkrete që mund të lehtësojnë dhe ndihmojnë rimëkëmbjen e rrjetit të operatorëve dhe vetë turizmit gjatë kësaj periudhe jo të lehtë për ekonominë mbarëbotërore.

## ASISTENCA AFTERCARE



Në zbatim të Planit të Veprimit të ndërmarrë nga AIDA në ndihmë të bizneseve të prekura prej situatës së krijuar nga COVID-19, Stafi i Sektorit Investime & Aftercare u ka komunikuar elektronikisht paketën për marrjen e masave të përkohshme për sektorin e turizmit, operatorëve dhe agjencive të udhëtimit operues në vend.



Në vijim është realizuar dhe një *tour* me telefonata me disa prej subjekteve që zhvillojnë shërbimin e tyre në këtë sektor, si dhe me shoqata biznesi që përfaqësojnë zërin e këtij sektori.

Shoqata e Turoperatorëve dhe Agjencive Turistike (ATOA) ka përcjellë problematikat e raportuara, duke ofruar gjithashtu sugjerime konkrete që mund të lehtësojnë dhe ndihmojnë rimëkëmbjen e rrjetit të operatorëve dhe vetë turizmit gjatë kësaj periudhe jo të lehtë për ekonominë mbarëbotërore.



Telefonatat janë zhvilluar duke komunikuar me subjektet me qëllim përcaktimin e situatës së krijuar dhe evidentimin e ndikimit që COVID-19 ka pasur në sektorin turistik, problematikat kryesore që bizneset kanë hasur, mënyrat e menaxhimit të situatës, si dhe mbledhjen e komenteve dhe sugjerimeve mbi masa shtesë, që janë gjykuar nga ana e bizneseve si të nevojshme për t'u ndërmarrë nga Qeveria.

## KOMENTE DHE SUGJERIME NGA BIZNESI

### KOMENTE

Bizneset e kontaktuar kanë shprehur komentet e tyre për sa i përket masave të ndërmara nga Qeveria në përgjigje të situatës së krijuar nga COVID-19. Si masat më pozitive janë vlerësuar:

- Shtyrja e pagesave mbi tatim fitimin për vitin 2019.
- Masat e vecanta të marra për operatorët turistikë, agjencitë e udhëtimit dhe klientët, pasi në këtë mënyrë lehtësohet komunikimi me klientët e tyre, krijohet një mjedis më i sigurt për menaxhimin e situatës dhe qartësohet procedura duke vendosur mundësinë e shtyrjes së prenotimeve përmes kuponit (*voucher*) me mundësi ripërdorimi brenda një viti dhe jo detyrim të menjëhershëm për kthim të pagesave të bëra nga klientët.
- Disa janë shprehur që masat e marra deri më tani nuk kanë pasur një impakt të konsiderueshëm për bizneset e tyre.
- Për sa i përket pagës së luftës ka rezultuar që disa biznese e kishin përfituar, disa kishin aplikuar por ende nuk e kishin përfituar, ndërsa disa nuk kishin aplikuar.

### SUGJERIME

Disa nga sugjerimet e marra përmes komunikimit të drejtpërdrejtë me bizneset që i drejtohen Qeverisë Shqiptare janë si vijon:

- Të stimulohen financiarisht tur-operatorët e huaj dhe/ose ata vendas për sjelljen e çdo turisti të huaj në Shqipëri për një kohëzgjatje prej minimumi 4 netë akomodimi në strukturat akomoduese shqiptare. (Ardhja e turistëve të huaj varet nga rrethana të tjera sic mund të jenë rregullat për hyrje-dalje të kufijve, rregullat e karantinimit të detyrueshëm etj.)
- Të rishikohet premtimi i mbështetjes nga Qeveria me pagesa të sigurimeve shoqërore për bizneset turistike me profil sezonal dhe që kryesisht nuk kanë mundësi për zhvillimin e aktivitetit gjatë periudhës së dimrit.

- Të përfshihen në subjektet që përfitojnë nga paketa e mbështetjes financiare me pagën e luftës edhe punonjësit e Tur-operatorëve Incoming & Outgoing, pjesë e biznesit të madh, si dhe të rishikohet vazhdimi i mbështetjes financiare nga shteti për punonjësit që janë larguar nga puna, ose për atë grup punonjësish që për arsye të situatës nuk do punojnë dot për një kohë të gjatë. Pagat për punonjësit të jepen për një periudhë deri në fillimin e pakufizuar të fluturimeve dhe hapjen e plotë të kufijve ajrorë/tokesorë/detarë dhe pa detyrim karantinimi brenda apo jashtë vendit.
- Të shqyrtohet mundësia e masave stimuluese për turistët nga rajoni dhe me qëllim nxitjen e bërjes së pushimeve në Shqipëri. Një stimul mund të jetë heqja e taksës së Rrugës së Kombit vetëm gjatë sezonit turistik.
- Rimbursimi i TVSH-së, për të gjithë bizneset e sektorit të turizmit që kanë TVSH kreditore.
- Mundësia e hartimit të një pakete informuese mbi kriteret e vecanta të vendosura nga Shqipëria dhe shtetet e tjera, në kuadër të situatës së krijuar prej COVID-19, që duhet të respektohen për të udhëtuar në Shqipëri, apo nga Shqipëria në një destinacion tjetër si psh. mbi vizitat në muze, protokollet e shfrytëzimit të plazheve etj. Kjo do krijonte lehtësi si për operatorët turistikë dhe agjencitë e udhëtimit ashtu edhe për klientët nga ana tjetër, duke ju dhënë paraprakisht informacionin e duhur.
- Rishikimi i detyrimit dhe sanksioneve të parashikuara për operatorët turistikë dhe agjencitë e udhëtimit që në pamundësi të zbatimit të përdorimit të kuponit(*voucher*)t'i rimbursojnë klientit vlerën/shumë totale të paguar, pasi kthimi i pagesës varet edhe prej kompanive ajrore/tokësore/detare kundrejt të cilave e kanë bërë pagesën, gjë e cila i vendos palët në një pozitë shumë të vështirë.
- Shqyrtimi i mundësisë së një ndihme financiare shtesë, pasi e gjykojnë si të pamjaftueshme pagën e luftës prej 40.000, ndërkohë që impakti i krizës vijon të jetë shumë i madh për ta.
- Në mungesë të fondeve shtetërore për një ndihmë financiare të dedikuar vetëm për këtë segment të industrisë së turizmit, propozohet rikthimi i tatimit fitimit të paguar për vitin 2018 si një formë ndihme financiare (që subjektet të kenë mundësi të plotësojnë një pjesë të humbjeve nga ofertat e parapaguara) ose heqja e detyrimit për të paguar tatim fitimin për

vitin 2019. Lidhur me këtë rekomandim të fundit, më poshtë është bërë një analizë më e plotë.

## IMPAKTI I TATIM FITIMIT TË PAGUAR NGA AGJENCITË/OPERATORËT TURISTIKË NË EKONOMI

Riskedulimi i afatit të pagesave të tatim-fitimit për vitin 2019 nga ata tatim-pagues që janë subjekt i *Ligjit Nr.3438 datë 28.12.1998 “ Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar*, është vlerësuar si një nga masat më pozitive të marra në ndihmë të biznesit.

Në zbatim të Planit të Veprimit të ndërmarrë nga AIDA në ndihmë të bizneseve të prekura prej situatës së krijuar nga COVID-19, është realizuar një analizë, për sa i përket impaktit që ka në ekonomi pagimi i tatim-fitimit nga bizneset, të cilat operojnë në Shqipëri si agjenci apo operatorë turistikë të licencuar. Duke u bazuar tek të dhënat zyrtare të siguruar prej databazës së QKB lidhur me numrin e përgjithshëm të subjekteve që operojnë në këtë sektor, rezulton që rreth **671 subjekte** ushtrojnë aktualisht veprimtari si agjenci apo operatorë turistikë.

Në analizën e realizuar nga Departamenti i Investimeve dhe After-care janë marrë në konsideratë informacionet e publikuara për vitin 2018 nga ato subjekte, të cilat kanë detyrim ligjor publikimin e pasqyrave financiare, për të gjykuar kështu rreth impaktit që ka pagimi i tatim fitimit nga këto subjekte në buxhetin e shtetit. Megjithatë duhet të marrim parasysh që ky impakt varet edhe nga faktorë të tjerë makro-ekonomikë, si dhe nga situata sezonale e vetë sektorit të turizmit vit pas viti.

**Referuar analizës së të dhënave ka rezultuar që 251 subjekte kishin të dhëna mbi vlerën e tatim fitimit për vitin ushtrimor 2018. Tatim fitimi i paguar nga 251 subjektet për vitin 2018 ka kontribuar në buxhetin e shtetit në shifrën 169,010,756 ALL.**

## ANEKS 1

### MASAT E PËRKOHSHME PËR MBËSHTETJEN E SEKTORIT TË TURIZMIT

Me synim përballimin e pasojave të shkaktuara nga COVID – 19 në Sektorin e Turizmit, Këshilli i Ministrave ka miratuar **Aktin Normativ Nr. 26 datë 10.06.2020 “Për marrjen e masave të përkohshme për mbështetjen e sektorit të turizmit”**.

Ky akt ka për qëllim mbështetjen e sektorit të turizmit, për subjektet e përcaktuara, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke ofruar një balancim dhe siguri ekonomike në funksion të përmbushjes së kërkesave të klientëve, në një mjedis të sigurt, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga COVID- 19.

Akti normativ ka për objekt përcaktimin e masave të veçanta që do të merren në sektorin e turizmit, për **agjencitë e udhëtimit, operatorët turistikë dhe klientët e tyre**, në ofrimin e një shërbimi udhëtimi, nga dita e shpalljes deri në përfundim të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga COVID-19. Këto masa zbatohen në rastet kur shërbimi i udhëtimit është objekt transaksioni nga/dhe agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë, vendas apo të huaj, që zhvillojnë veprimtarinë turistike sipas legjislacionit në fuqi.

#### **AKTI PARASHIKON:**

- Operatorët turistikë apo agjencitë e udhëtimit, të cilët, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose si ndërmjetës, kanë marrë përsipër t’u ofrojnë klientëve çdo lloj shërbimi udhëtimi apo një sërë shërbimesh të tjera ndihmëse, dhe këto shërbime janë të parapaguara ose të rezervuara përpara shpalljes dhe gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore, të kryejnë rimbursimin e tyre, brenda **1 viti** nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ, përjashtimisht detyrimeve të parashikuara shprehimisht në kontratë.
- Operatorët turistikë apo agjencitë e udhëtimit, që kanë lidhur kontrata ndërmjetësimi për shitjen e shërbimeve të ofruara nga furnizuesit e shërbimeve të udhëtimit me klientin dhe këto shërbime janë të parapaguara ose të rezervuara përpara shpalljes dhe gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore, të kryejnë rimbursimin e tyre, brenda **1 viti** nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ, përjashtimisht detyrimeve të parashikuara shprehimisht në kontratë.

- Klienti i një pakete udhëtimi apo dokumenti udhëtimi, nga/apo nëpërmjet agjencive të udhëtimit ose operatorit turistik, për shërbimet e udhëtimit të parapaguara përpara shpalljes dhe gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore, përfiton rimbursimin e tyre brenda **1 viti** nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ, përjashtimisht detyrimeve të parashikuara shprehimisht në kontratë.
- Në rast të pamundësisë së realizimit të kontratave të transportit të klientëve me mjetet e transportit ajror nga/dhe aeroporti ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Tiranë, transportit detar nga të gjitha portet në vend ose ujërave të brendshme, si pasojë e masave kufizuese të ndërmarra për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga COVID-19, subjektet e parashikuara në pikat e mësipërme, detyrohen të njoftojnë, sipas rastit, respektivisht **agjencinë/transportuesin/akomoduesin ose organizatorin e paketave të udhëtimit/klientin** për pamundësinë e zbatimit të kontratave të transportit, duke bashkëlidhur dokumentacionin që vërteton dokumentin e udhëtimit ose rezervimin e qëndrimit ose kontratat e paketave të udhëtimit.

**Ky komunikim bëhet brenda 30 ditësh nga:**

- a) hyrja në fuqi e këtij akti normativ, për shërbimet/kontratat, të cilave iu ka përfunduar afati;
  - b) data e planifikuar e nisjes apo e mbërritjes, për shërbimet/kontratat brenda afatit.
- Operatorët turistikë apo/ose agjencitë e udhëtimit, brenda **30 ditësh** nga komunikimi i mësipërm duhet të rimbursojnë dokumentin e udhëtimit dhe/ose paketën e udhëtimit nëpërmjet lëshimit të një kuponi (*voucher*), që korrespondon me të njëjtën vlerë/shumë totale që duhet të kthehet, duke i ofruar klientit mundësinë e përdorimit të kuponit për të njëjtin shërbim ose një të ngjashëm, që i përket kontratës së ndërprerë, e cila do të përdoret brenda **1 viti**. Në rast se nuk realizohet ky shërbim, operatorët turistikë apo/ose agjencitë e udhëtimit duhet t’i rimbursojnë klientit vlerën/shumë totale të paguar.

**SANKSIONE**

Operatorët turistikë apo/ose agjencitë e udhëtimit, të cilët nuk e zbatojnë këtë akt normativ, përveç përmbushjes së detyrimeve kontraktuale ndaj klientit, dënohen me gjobë, për çdo kontratë të parealizuar, sipas masës së parashikuar në shkronjën “dh”, të pikës 1, të nenit 71, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar.